



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:094905

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05435046

KF.nr.200/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “PAN MED” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810523797 dhe seli në rr. Hajvali” në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.Rr. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit të ATK-së nr.prot.95/2021 të datës 26.04.2021, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me datë 20.02.2024 në prani të avokatit të palës paditëse A.Rr., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit “PAN MED” Sh.P.K., me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET vendimi nr.prot.95/2021 të datës 26.04.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë-Departamentit të Ankesave, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës në konflikt administrativ

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 19.05.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.95/2021 të datës 26.04.2021, me të cilin i është refuzuar ankesa e paditësit me nr.95/2021 e datës 15.03.2021. Përfaqësuesi i palës paditëse si në padi dhe në seancë ka deklaruar se mbesin në tërësi pran padisë të datës 19.05.2021, po ashtu në këtë seancë

i ka dorëzuar gjykatës parashtresën mbi zgjerimin dhe ndryshimin e kërkesëpadisë ashtu që tani ka kërkuar që e paditura përveç tatimit shtesë dhe interesit në shumë totale 4,716.26 €, t'ia paguaj edhe kamatën ligjore prej 8% në vit që nga data 19.05.2021. Tutje ka theksuar se pas administrimit të provave materiale të bashkangjitura padisë do të vërtetohen pretendimet e tyre që rrjedhimisht do të vërtetohet se vendimi i të paditurës është marr me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike e që si pasojë ka rezultuar me zbatim të gabuar të dispozitave të Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe Ligjit mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Më tej në fjalën përfundimtare ka theksuar se e paditura me rastin e nxjerrjes të vendimit të kontestuar me këtë padi ka vepruar në tërësi në kundërshtim me gjendjen faktike, sepse nga këto prova u vërtetua se shuma prej 63,000.00 € është marrë në formë të huazimit dhe si e tillë nuk ka qenë e hyrë nga çfarëdo furnizimi apo shërbimi dhe kjo më së miri vërtetohet nga kontrata mbi huan e datës 16.10.2018 si dhe nga transaksioni bankar me nr... i datës 16.10.2018. Andaj shton se duke marrë parasysh këto rrethana e paditura ka bërë edhe shkelje të nenit 6 të LTAK-së për shkak se në kundërshtim me gjendjen faktike këto mjete i ka konsideruar si të hyra dhe rrjedhimisht ka ndikuar që e njëjta të zbatojë gabimisht edhe dispozitat e nenit 3 dhe 22 të Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Më tej ka theksuar se në rastin konkret nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës se kinse paditësi nuk ka dorëzuar me kohë kontratën e huas dhe kinse e njëjta nuk është e noterizuar dhe kjo për faktin se paditësi në të gjitha fazat e procedurës në vazhdimësi i ka dorëzuar të njëjtat prova materiale, mirëpo të njëjta nuk janë marrë parasysh nga e paditura. Ndërsa sa i përket çështjes së kontratës së huas e ka cekur se e njëjta është hartuar në tërësi në pajtim me dispozitat e LMD-së në fuqi që rregullojnë çështjen e kontratës së huas, prandaj e njëjta i përmban të gjitha elementet e kërkuara me dispozitat ligjore, ndërsa me asnjë dispozitë ligjore në fuqi nuk kërkohet që kontrata e huas të noterizohet apo vërtetohet pranë ndonjë organi shtetëror. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar ashtu që të vendos në mënyrë meritore dhe sipas parashtresë të dorëzuar me datë 20.02.2024.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 14.12.2021 ka deklaruar se e konteston në tërësi si të pabazë padinë dhe konsideron se vendimi i DA/ATK-së është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Më tej ka deklaruar se paditësi në padinë e tij ka përsëritur pothuajse të njëjtat pretendimet të cilat i ka paraqitur edhe në Departamentin e Ankesave të ATK-së dhe për të cila pretendime DA ka nxjerr vendimin në përputhje të plotë me legjislacionin tatimor dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative. Tutje ka theksuar se ATK ka vepruar në bazë të dispozitave ligjore të legjislacionit tatimor, neni 19 i Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat,

ndërsa paditësi nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore nga legjislacioni tatimor. Po ashtu thekson se paditësi nuk ka sjell dëshmi-kontratën e huazimit gjatë kryerjes së vlerësimit dhe pas dorëzimit të draft raportit është sjell një kontratë e pa protokolluar dhe e pa noterizuar. Më tej në parashtrësën e datës 15.02.2024 i ka kërkuar gjykatës që të veproj në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të Ligjit nr.03L-202 për Konfliktin Administrativ, citon *“Gjykata mund të vendos çështjen pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme dhe kur palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar”*. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj padinë e paditësit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i DA/ATK-së nr.95/2021 i datës 26.04.2021, ndërsa me datë 28.02.2024 përmes parashtrësës ka kundërshtuar zgjerimin dhe ndryshimin e padisë duke theksuar se në rastin konkret nuk mund të zbatohen dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, por duhet zbatuar legjislacioni tatimor, përkatësisht neni 82 par 4 i Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 20.02.2024, ka administruar provat dhe atë: Parashtrësja e paditësit me datës 20.02.2024, Certificate e regjistrimit të biznesit me datë 16.08.2011, Vendimi i ATK-së DA me nr.prot.95/2021 datës 26.04.2021, Raporti i kontrollit datës 15.02.2021, Ankesë e datës 15.03.2021, E-mail i datës 10.02.2021, Kontratë mbi huan e të hollave e datës 16.10.2018, Dëftesë e transaksionit e datës 16.10.2018, Faturë me nr.180925 e datës 25.09.2018, Pagesa e faturës e datës 16.10.2018, Formular i deklarimit të TVSH-së , Letër kujtesë për pagesë e datës 05.05.2021 në shumë prej 97.57 €, Pagesa e datës 05.05.2021 periudha prill, Letër kujtesë e datës 05.05.2021 në shumë prej 534.05 €, Pagesa në vlerë prej 534.05 e datës 05.05.2021 periudhë mars, Letër kujtesë për shumën prej 534.05 €, Pagesa në vlerë prej 534.05 € për periudhën shkurt 2020, Letër kujtesë për periudhën janar 2020 në shumë prej 317.61 €, Pagesë e datës 05.05.2021 në shumë prej 317.61 €, Letër kujtesë për periudhën dhjetor 2019 në vlerë prej 546.93 € me fletëpagesë të datës 05.05.2021, Letër kujtesë për periudhën nëntor 2019 në vlerë prej 550.15 € me fletëpagesë të datës 05.05.2021, Letër kujtesë për periudhën tetor 2019 në vlerë 553.37 € me fletëpagesë të datës 05.05.2021, Letër kujtesë për periudhën shtator 2019 në vlerë prej 556.59 € me fletëpagesë të datës 05.05.2021, Letër kujtesë për periudhën gusht 2019 në shumë 493.77 € me fletë pagesë të datës 05.05.2021, Përgjigje në padi e datës 14.12.2021, Pasqyrë bankare data e shtypjes 28.09.2020, E-mail i datës 26.01.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e

veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga vendimi i kontestuar i ATK-së me nr.95/2018 i datës 26.04.2021, gjykata konstaton se e paditura ATK ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar Njoftim Rivlresimin e tatimit shtesë të caktuar me kontrollë. E paditura në arsyetim të vendimit të kontestuar ka theksuar se tatimpaguesi nuk e ka sjell kontratën e huazimit me kohë, pastaj për me qenë edhe më e besueshme kontrata është dashtë me qenë e noterizuar tek Noteri.

Nga vendimi i kontestuar rezulton se ai përmban të meta të tilla që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së tij. Gjykata gjen se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për zgjidhjen e çështjes në shqyrtim. Në fakt në vendimin e kontestuar përveç konstatimit se paditësi nuk ka ofruar me kohë kontratën për huan dhe nuk e ka dërguar të noterizuar, duke u mbështetur edhe në nenin 5 dhe 7 të UA 02/2016, ka konstatuar se paditësi nuk ka sjell prova materiale dhe bindëse dhe se e paditura nuk ka sqaruar faktin se si është vërtetuar se paditësi nuk ka vepruar konform nenit të lartcekur.

Nga raporti i kontrollit, si arsyetim i mospranimit të huamarrjes nga D.A. me datën 16.10.2018, në vlerën prej 63,000.00 euro rrjedh se nuk është cek data e kthimit të huazimit, si dhe nuk është ofruar kontrata e huazimit e kërkuar nga tatimit paguesi i cili me email ka deklaruar se nuk ka kontratë për këto mjete dhe meqë nuk ka dëshmi siç kërkohet me ligj kjo shumë është trajtuar si e hyrë për subjektin në fjalë si dhe vlerësimi final ka rezultuar me tatim shtesë, ulje kreditimi si dhe zvogëlim i humbjes.

Në këtë drejtim gjykata e ka të pa qartë faktin se si është ardhur deri tek konstatimi se paditësi nuk ka kontratë për huazim, kur në vendim thotë se është ofruar më vonë, por nuk është e noterizuar. Po ashtu e paditura nuk ka ofruar emailin për të cilin pretendon se pala ka deklaruar se nuk ka kontratë, e në të cilat dokumente është thirrur në vendimin e kontestuar, siç ka pasur obligim ta bëjë sipas nenit 37 paragrafi 3 të LKA-së. Gjykata konstaton se në shkresa të lëndës gjendet emaili i dërguar inspektorit tatimor F.Rr. me datë 10.02.2021 e cila rezulton të jetë dërguar para përfundimit të raportit të kontrollit i cili daton me 15.02.2021.

Konstatimin se kontrata është e pa protokolluar dhe e pa noterizuar gjykata e vlerëson si kontraditore me vet nenin e cituar nga e paditura, përkatësisht nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016 për zbatimin e nenit 5 të Ligjit mbi të Ardhurat e Korporatave, me të cilin përcaktohet se: *“E ardhur nga interesi në huadhënie konsiderohet çdo e ardhur e përfituar nga dhënia në formën e huas të mjeteve monetare apo mjeteve të ngjashme me to. 3.1. Për këtë kategori të të ardhurave llogaritja e detyrimit tatimor bëhet duke u bazuar në kontratën në mes palëve e cila përcakton: 3.1.1. Shumën e huas; 3.1.2. Afatin e kthimit të huas; 3.1.3. Pranimi-kthimi i huas duhet të bëhet përmes llogarive bankare; 3.1.4. Shkallën e interesit të huas duke u bazuar në vlerën e hapur të tregut; 3.2. Nëse nuk plotësohen kushtet e parapara në nënparagrafin 3.1. të këtij neni, huaja për qëllime tatimore trajtohet e ardhur për pranuesin e saj.”*. Nga neni i cituar rezulton se kontrata mbi huanë e parashtruar nga paditësi i përmban elementet e kërkuara, me përjashtim të shkallës së interesit e cila jo domosdoshmërisht është e kërkuar me Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve me të cilën edhe rregullohen kushtet për lidhjen e kësaj kontrate e nga të cilat, respektivisht me nenin 567 të LMD-së, parashihet se palët mund ta kontraktojnë kamatën, dhe se fjala mund nuk nënkupton obligim të domosdoshëm që kamata duhet të kontraktohet, e po ashtu e paditura nuk ka paraqitur bazën ligjore sipas të cilës kërkohet që kontrata të jetë e noterizuar.

Meqenëse e paditura në këtë konflikt administrativ nuk ka paraqitur prova materiale të cilat kishin me vërtetuar se paditësi ka deklaruar se nuk posedon dokumentacion, si dhe bazën ligjore se kontrata mbi huanë nuk mund të konsiderohet si e ligjshme, për arsye se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta, pastaj në pikat esenciale faktet nuk janë vërtetuar, rrjedhimisht edhe nga faktet të cilat janë vërtetuar është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, andaj gjykata vendosi të anuloi aktin e kontestuar dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

Rrjedhimisht, gjykata e obligon të paditurën që në rishqyrtim dhe rivendosje që fillimisht të deklarohet se mbi bazën e cilave provave dhe fakteve relevante e ka vërtetuar faktin se paditësi nuk ka ofruar dëshmi për hua dhe se ka deklaruar se të njëjtat nuk i posedon, ndërsa më vonë kontratën e ofruar nuk e ka vlerësuar si të mjaftueshme, të cek bazën ligjore për një veprim të tillë si dhe praktikën e organit të paditur në trajtimin e rasteve të ngjashme.

Gjykata vlerëson se të metat e lartcekur janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, kështu që gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë

të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të cekurat më lart gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.200/22, datë 29.02.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.